

M E N D I M

I

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

PROJEKTLIGJIN JOQEVERITAR “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.96/2016, “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka dërguar për mendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të paraqitur si iniciativë propozuese nga deputetët znj. Aulona Bylykbashi dhe z. Admir Kadeli.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 82, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave shprehet me vendim për projektligjet joqeveritare, që bëjnë të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose pakësojnë të ardhurat.

Nisma për propozimin e projektligjit në fjalë synon realizimin e një sërë ndryshimeve në nenin 12, të ligjit nr.96/2016, të cilat kanë të bëjnë me caktimin e pagës së magjistratit.

Pas shqyrtimit të projektligjit, në kushtet që caktimi i pagës së magjistratëve bëhet vetëm me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, sipas parashikimeve të vendimit nr.15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Ministrave shprehet mbi efektet financiare dhe buxhetore, që rrjedhin nga zbatimi i projektligjit, si më poshtë vijon:

1. Në paragrafin 110 të vendimit nr.15, datë 17.2.2026, Gjykata ka përcaktuar shprehimisht se *“efektet financiare të ligjit të ri duhet të llogariten po nga data 1.4.2023, duke përcaktuar një skemë të arsyeshme përshtatjeje për pagesat e prapambetura për periudhën nga data 1.4.2023 deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri”*.

Nga analiza e kryer rezulton se zbatimi i projektligjit sjell efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit, si vijon:

- Për periudhën 1.4.2023 - 31.12.2023, efekti financiar shtesë vlerësohet në masën rreth 260 milionë lekë;

- Për vitet 2024 dhe 2025, efekti financiar shtesë vlerësohet në masën rreth 740 milionë lekë.

Në total, detyrimet financiare të akumuluarra për periudhën 2023-2025 përlllogariten në masën rreth 1 miliard lekë.

Për vitin 2026, për periudhën 1.1.2026 - 31.7.2026, efekti financiar shtesë përlllogaritet, në masën rreth 250 milionë lekë, ndërsa në nivel vjetor arrin në rreth 500 milionë lekë. Ky efekt financiar pritët të reflektohet edhe në vitet buxhetore pasuese, pra vitin 2027 e në vijim.

Në total, efekti financiar shtesë për periudhën 2023-2026 vlerësohet në masën rreth 1.5 miliardë lekë, ndërsa duke konsideruar edhe efektin vjetor të përsëritshëm prej rreth 500 milionë lekësh, ndikimi financiar i përgjithshëm në buxhetin e shtetit arrin në rreth 2 miliardë lekë.

Këshilli i Ministrave vëren se vetë Gjykata Kushtetuese, në paragrafin 110 të vendimit nr.15/2026, ka orientuar përcaktimin e një “*skeme të arsyeshme përshtatjeje*” për pagesat e prapambetura dhe nuk ka përcaktuar shlyerjen e tyre të menjëhershme brenda një viti të vetëm buxhetor.

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh se kostoja shtesë e mësipërme nuk është reflektuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe se përballimi i saj në një vit të vetëm buxhetor do të sillte trysni të konsiderueshme mbi balancat fiskale, Këshilli i Ministrave vlerëson se zbatimi i detyrimeve financiare të krijuara nga efekti prapaveprues i projektligjit duhet të realizohet në mënyrë graduale, nëpërmjet një mekanizmi të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm financiar, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe me parimet e menaxhimit të financave publike. Ky vlerësim është në përputhje me orientimin e dhënë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.15/2026.

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave vëren se në kreun VII të relacionit shoqërues të projektligjit përcaktohet se institucioni i ngarkuar për zbatimin e tij është Ministria e Financave, përfshirë llogaritjen e pagesave të prapambetura nga data 1.4.2023. Në këtë drejtim, vlerësohet se një përcaktim i tillë nuk përputhet me kompetencat e Ministrisë së Financave, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financave publike. Ministria e Financave ushtron funksione në planifikimin, programimin dhe alokimin e fondeve buxhetore, ndërsa administrimi i marrëdhënieve financiare me përfituesit dhe verifikimi i të drejtave konkrete financiare mbetet përgjegjësi e institucioneve përkatëse punëdhënëse. Për rrjedhojë, vlerësohet i nevojshëm rishikimi i këtij përcaktimi në relacionin shoqërues të projektligjit.

Për sa më sipër, vlerësohet e përshtatshme që në përmbajtjen e projektligjit ose në dispozitat kalimtare të tij të parashikohet që detyrimet financiare të krijuara nga efektet prapavepruese të ligjit të likuidohen sipas një skeme financimi graduale, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe hapësirën fiskale të viteve

përkatese buxhetore dhe të shlyhen jo më vonë se dy vite nga hyrja në fuqi e ligjit. Kjo zgjidhje vlerësohet në përputhje me orientimin e dhënë nga paragrafi 110 i vendimit nr.15/2026 të Gjykatës Kushtetuese për përcaktimin e një skeme të arsyeshme përshtatjeje për pagesat e prapambetura.